



Datë: 08.08.2025

Numër Protokolli: 5312/2025

A.nr.546/2025

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.546/2025, të datës 25.03.2025, të parashtruar nga ankuesi B.Rr të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat Ahmet Gjinovci nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike “*kundërshtim i masës disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.08.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet** si e bazuar ankesa me numër A.nr.546/2025, e datës 25.03.2025, e parashtruar nga ankuesi B.Rr.

**II. Anulohet** Vendimi me numër 01/384, i datës 12.03.2025, i Komisionit Disiplinor i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

**III. Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës që të ndërmerr të gjitha veprimet administrative në atë mënyrë që ankuesin ta kthej në vendin e tij të punës sipas Aktit të Emërimit të datës 28.12.2012, si dhe të bëjë të gjitha kompensimet e pagës së ndalur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**IV. Obligohet** Njësia e Personelit të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës që masën disiplinore të anuluar si në pikën II të diapozitivit ta largoj nga dosja personale e ankuesit si dhe regjistrat tjerë përkatës.

**IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra në zbatim të këtij vendimi.

## A r s y e t i m

Nëpunësi civil B.Rr (*tutje referuar vetëm ankuesja*), përmes përfaqësuesit të tij më autorizim, më datë 25.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 01/384, të datës 12.03.2025, të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për shkak të vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.04.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (tutje referuar SKGJK), ndërsa, ky e fundit, më datë 22.04.2025 ka përcjell përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

***Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave për vendosje të drejtë dhe meritore lidhur me këtë çështje juridike –administrative ka administruar këto prova:*** Ankesën me numër protokolli 1982/2025 të datës 25.03.2025, e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimin me numër 01/384 të datës 12.03.2025 të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Aktgjykimin PML.nr.478/2p024, të datës 09.08.2024 të Gjykatës Supreme të Kosovës; Autorizimin e datës 25.03.2025; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 01.04.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 22.04.2025; Vendimin me numër Reference: DS-1385/2024 të datës 23.09.2024 për përfundimin e marrëdhënies së punës; Vendimin me numër Reference:DS-1573/2024 të datës 11.11.2024; Vendimin me numër 03/3900 të datës 12.11.2024; Akt Emërimit e datës 28.12.2012 të ankuesit; Vendimin me Nr. 117/19 të datës 25.02.2019 për pezullimin parandalues të ankuesit; Vërejtje me shkrim e datës 20.04.2015; Njoftimin për shqiptimin e vërejte me shkrim i datës 01.03.2018; Inicimin e procedurës disiplinore e datës 11.11.2024; Kërkesën e ankuesit për kompensim të dëmit jo material e datës 17.10.2024; Aktvendimin PPRKR.nr.52/19 të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e ankuesit është e bazuar, **sepse:**  
Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë kjo gjendja faktike:

-Ankuesi sipas Aktit të Emërimit të datës 28.12.2012, është emëruar në pozitën Ndhmës Referent për Ekzekutime në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

- Më Vendimin me numër protokolli 117/19, të datës 25.02.2019, të Administratorit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ankuesi ishte pezulluar nga puna me 50% të pagës, deri në përfundimin e procedurës penale me vendim të formës së prerë.

-Gjykata Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda, me Aktgjykimin PKR.nr.50/2022 të datës 18.04.2023, ka shpallur fajtor ankuesin për veprën penale ushtrimi i ndikimit duke e dënuar me gjobë në lartësi prej dymijë (20000) euro dhe dënim plotësues ndalim i ushtrimit të profesionit në institucionet publike në kohëzgjatje prej një (1) viti nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

-Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Krime të Rënda me Aktgjykimin PAKR.nr.323/2024 të datës 10.06.2024, ka refuzuar ankesën e mbrojtësit të ankuesit ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

- Drejtori i Përgjithshëm i SKGJK-së, bazuar në Aktgjykimin PKR.nr.50/2022 të datës 18.04.2023 dhe PAKR.nr.323/2024 të datës 10.06.2024, më Vendimin më numër Reference: DS-1385/2024, të datës 23.09.2024, ankuesit i ka përfunduar marrëdhënien e punës së ankuesit.

-Ankuesi kishte ushtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër Aktgjykimit PKR.nr.50/2022 të Gjykatës Themelore në Gjilan dhe Aktgjykimit PAKR.nr.323/2024 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, ashtu që Gjykata Supreme e Kosovës, më Aktgjykimin PML.nr.478/2024, të datës 09.08.2024, ka miratuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së ankuesit

duke ndryshuar aktgjykimet e dy gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë dhe duke vendosur që të Refuzohet Akuza, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

-Drejtori i Përgjithshëm i SKGJK-së, më datë 11.11.2024, ka nxjerr Vendim me numër Reference: DS:1573/2024, me të cilin ka shfuqizuar Vendimin me numër Reference: DS-1385/2024 të datës 23.09.2024, duke e obliguar mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të ankuesit që të ndërmerr veprimet ligjore në lidhje me rastin e ankuesit bazuar në dosjen personale.

-Administratori i Gjykatës Themelore në Prishtinë, më datë 11.11.2024, ka paraqitur kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit, me arsyetimin se : ankuesi ka kryer shkelje të rënda sipas nenit 8 të Rregullores Nr. 03/2024, pika 3.9, *përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë apo tërthortë të dhuratave, favoreve apo trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës*, si dhe nenit 3.11, *përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy apo më shumë herë*. Andaj, meqenëse rasti penal është parashkruar nuk do të thotë që është vërtetuar pafajësia e tij, mbi këtë bazë ka bazë juridike që rasti të procedohet për procedurë disiplinore, ku sipas kërkesës është propozuar masa disiplinore adekuate dhe pezullimi nga puna deri në përfundimin e procedurës.

-Komisioni Disiplinor i SKGJK-së, më Vendimin Nr.03/3900, të datës 12.11.2024, ka bërë pezullimin e përkohshëm të nëpunësit civil/ankuesit nga detyra e punës për pesëdhjetë (50%) të pagës deri në marrjen e vendimit përfundimtar, ndërsa, më datë 05.03.2025, më vendimin e kontestuar ka shpall përgjegjës ankuesin për shkelje të rënda disiplinore të përcaktuar me nenin 51, 52, paragrafi 1, 4, 5, nenin 53, nenit 63 paragrafi 2, nenit 67 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 pika 1.2.3. të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Kodit të Mirësjelljes për Personelit e Administratës Gjyqësore, duke i shqiptuar masën disiplinore: *largim nga zyra dhe sistemimin nga pozita Referent në pozitën Dorëzues në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dhe ndalimi i gradimit për periudhën pesë (5) vjeçare, dhe ndalimi i 50% të pagës sipas vendimit për pezullim të përkohshëm të nëpunësit civil të datës 25.02.2019 përkatësisht datës 11.11.2024 do të jetë pjesë e kësaj masë dhe nuk do t'i kthehet subjektit të hetimit disiplinor të kësaj procedure.*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit me numër 01/384 të datës 12.03.2025 të Komisionit Disiplinor të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke pretenduar së vendimi i kontestuar është nxjerr në kundërshtim me provat materiale të lëndës dhe zbatim të gabuar të Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe atë vetëm në dëm të ankuesit. Kërkon që ankesa të aprovohet, vendimi kundërshtuar me ankesë të ndryshohet ashtu që, të kthehet në vendin e punës me të gjitha të drejtat dhe detyrimet dhe të bëhet kompensimi i 50% të pagës nga data 25.02.2019 deri në tani ose të çështja të kthehet në Komisionin Disiplinor në rishqyrtim dhe rivendosije.

Kolegji i Këshillit në kuptim të vendosjes meritore analizoj aktin e kontestuar në ndërlidhje më provat e lëndës, dhe si rrjedhojë konstatoi se trajtimi i çështjes disiplinore të ankuesit është bërë mbi bazën e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku i njëjti më neni 63 në mënyrë shprehimore përcaktonte: *Nëpunësit civil do t'u nënshtrohen masave disiplinore për shkelje të detyrës, që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre, sikur që është përcaktuar me këtë ligj. 2. Përgjegjësia personale për kryerjen e një veprë penale ose kundërvajtje gjatë ushtrimit të detyrave administrative nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore të nëpunësit civil, me kusht që vepra gjithashtu të përbëjë shkelje të detyrës, siç është përcaktuar me këtë ligj. 3. Në rast të inicimit të procedurës penale kundër nëpunësit civil për kryerjen e veprës penale gjatë ushtrimit të mandatit të tij/saj administrativ, që mund të rezultojë në krijimin e kushteve për ngritjen e padisë kundër nëpunësit civil, të gjitha procedurat disiplinore lidhur me rastin nuk mund të iniciohen deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata kompetente. 4. Nëse nëpunësi civil shpallet fajtor dhe dënohet për kryerje të veprës penale, autoritetet*

*kompetente administrative detyrohen që nga ato elemente të vendimit të gjykatës kompetente, që përbëjnë shkelje të parimeve dhe të rregullave administrative, duhet të urdhërojnë shkarkimin e nëpunësit civil. 5. Nëse nëpunësi civil i akuzuar për kryerje të veprës penale shpallet i pafajshëm: 5.1. ai/ajo do të kthehet në vendin e punës dhe në dosje nuk do të përfshihet asnjë përmendje e procedurës penale dhe/ose pezullimit parandalues; 5.2. asnjë masë disiplinore nuk do të merret kundër nëpunësit civil pas shpalljes i/e pafajshëm ose përjashtimit nga një procedurë penale. Ndërsa me nenin 69 të këtij ligji parashihej se 1. Nëpunësit civil pezullohen, me pagesë 50% të rrogës së tij/saj, menjëherë nga detyra nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës nëse: 1.1. kundër tij/saj është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të tij/saj; 1.2. nëpunësi civil mbahet në arrest në pritje të gjykimit; 1.3. kur prania e nëpunësit civil në zyrë mund të pengojë hetimet. 2. Në rast të pezullimit parandalues, nëpunësi civil do të marrë 50% të rrogës së tij/saj gjatë tërë kohëzgjatjes së pezullimit, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata, 3. Nëse nëpunësi përkatës civil më pas rikthehet në shërbim, qoftë për shkak se akuza kundër tij/saj nuk ka mundur të dëshmohet, për shkak të dyshimit ose arsyeve të tjera teknike, ai/ajo duhet të konsiderohet se është pezulluar nga ushtrimi i detyrës. Periudha e mungesës do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësi civil duhet të marrë rrogën e plotë dhe mëditjet të cilat ai/ajo do t'i kishte marrë nëse nuk do të ishte pezulluar nga shërbimi.*

Andaj referuar bazës ligjore si më lartë, dhe duke qenë se akuza ndaj ankuesi nuk është vërtetuar për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale siç është theksuar sipas Aktgjykimit PML.nr.478/2024 të datës 09.08.2024 të Gjykatës Supreme të Kosovës, atëherë, Kolegji vlerëson se, Komisioni Disiplinor nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike dhe gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, në rrethanat e rastit konkret, dhe nisur nga fakti se akuza ndaj ankuesit është refuzuar, pra nuk ka konstatim të gjykatës për fajësinë e ankuesit për vepër penale të akuzuar, atëherë, vetën në rastet kur nëpunësi shpallet fajtor dhe dënohet për kryerje të veprës penale, autoritetet kompetente administrative detyrohen që nga ato elemente të vendimit të gjykatës kompetente, që përbëjnë shkelje të parimeve dhe të rregullave administrative, duhet të urdhërojnë shkarkimin e nëpunësit civil.

Kolegji për trajtimin dhe vendosje meritore lidhur me këtë çështje administrative, mori parasysh praktikën e konsoliduar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, si dhe praktikën gjyqësore lidhur me çështje të ngjashme si Vendimin e KPMSHC-së, A.nr.828/2018 të datës 02.04.2021 i vërtetuar me Aktgjykimin A.nr.990/21 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Aktgjykimin AA.nr.520/2023 nga Gjykata e Apelit e Kosovës. Kështu që, bazuar në konstatimet si më lartë, Kolegji erdhi në përfundimin së vendimi i kontestuar më ankesë është nxjerrë në kundërshtim me ligjin material, andaj, në kuptim të nenit 52, paragrafi 1, nënpike 1.5 të dhe Ligjit Nr.05/L-2031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një akt administrativ i nxjerr në kundërshtim më dispozitat materiale është akt i paligjshëm, dhe si pasojë Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, gjegjësisht, aprovoj ankesën si të bazuar, duke detyruar Drejtorin e Përgjithshëm të SKGJK-së, që ankuesin ta kthej në vendin e tij të punës sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2012, dhe të njëjtit t'i bëjë kompensimin e pagave të pa paguara si dhe obligohet Njësia e Personelit të SKGJK-së edhe masën disiplinore të anuluar si në pikën II të dispozitivit, ta largoj nga dosja personale e ankuesit dhe regjistrat përkatës.

***Këshillë juridike:*** Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda: A.nr.546/2025*

**Avdyl BEKTESHI**

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*Procesmbajtës*

*Kryetare e Kolegjit*

**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat Ahmet Gjinovci;
- SKGJK: Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore
- Arkivit të KPMSHCK-së.